



Reclassified as Public pursuant to instructions contained in CRSPD103 in KSC-BC-2018-01 of 11 September 2025

Numri i lëndës: KSC-BC-2018-01

Vendosi: Paneli i përbërë prej Gjykatës së Vetme
Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 16 korrik 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial dhe *Ex Parte*

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Garanci për Mbrojtjen e Privilegjit Ligjor

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Luka Mishetiç

Administratores

Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Viktimave

Sajmon Loz KC

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Trupit Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSJA E VETME,¹ në bazë të neneve 21(4)(c), 33(2), 34(1) dhe (12) dhe 35(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 23(7) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 dhjetor 2023, me kërkesë të Mbrojtjes së Hashim Thaçit ("z. Thaçi" dhe "Mbrojtja e Thaçit"), Kadri Veselit ("z. Veseli" dhe "Mbrojtja e Veselit"), dhe Rexhep Selimit ("z. Selimi" dhe "Mbrojtja e Selimit") (së bashku "të akuzuarit në Çështjen 06"),² pas marrjes dijeni se, për periudha të caktuara gjatë vitit 2023, Gjykatësi i Vetëm kishte autorizuar masa hetimore të posaçme ("MHP") lidhur me audioincizimin e fshehtë të vizitave të paprivileguara të të akuzuarve në Çështjen 06 brenda objektit të paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") ("masat hetimore të posaçme monitoruese"),³ Gjykatësja e Vetme lëshoi Vendimin mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Masa për Garantimin e Privilegjit Mbrojtës-Klient, duke konfirmuar dhe dhënë garanci lidhur me kuadrin e masave hetimore të posaçme monitoruese ("Vendimi mbi Garancitë").⁴

2. Më 17 qershor 2024, Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Veselit, Mbrojtja e Selimit dhe Mbrojtja e Jakup Krasniqit ("z. Krasniqi" dhe "Mbrojtja e Krasniqit") (së bashku

¹ KSC-BC-2018-01, F00697, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Vetme*, 6 qershor 2024, publik. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 12 korrik 2024, F00697/COR.

² KSC-BC-2018-01, RAC001/F00005, Mbrojtja e z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi, *Kërkesë Urgjente e Mbrojtjes për Masa për Garantimin e Privilegjit Mbrojtës-Klient*, 1 dhjetor 2023, konfidenciale dhe ex parte.

³ Shih KSC-BC-2018-01, RAC001/F00003, Mbrojtja e z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi, *Kërkesë Urgjente e Mbrojtjes për Riklasifikimin e Parashtrimeve të Tjera të Protokolluara, Pezullimin e Afateve dhe Zgjatjen e Afatit për Leje për Apelimin e Vendimeve lidhur me Autorizimin e Incizimeve të Fshehta dhe Kërkesat e Mëparshme lidhur me Të, 27 nëntor 2023, konfidenciale dhe ex parte, para. 3. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 28 nëntor 2023, F00003/COR.*

⁴ KSC-BC-2018-01, RAC001/F00011, Gjykatësja e Vetme, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Masa për Garantimin e Privilegjit Mbrojtës-Klient*, 19 dhjetor 2023, konfidencial dhe ex parte.

“Mbrojtja” ose “të akuzuarit”) dorëzuan Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Garantimin e Mbrojtjes së Privilegjit Ligjor” (“Kërkesa”).⁵

3. Më 28 qershor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) iu përgjigj Kërkesës (“Përgjigjja”).⁶ Mbrojtja nuk u kundërpërgjigj.

II. PARASHTRIME

4. Në këtë Kërkesë, ku Mbrojtja vë në dukje se nuk ka marrë informacion të mëtejshëm lidhur me masat hetimore të posaçme aktuale apo ecurinë e hetimit të ZPS-së që prej Vendimit mbi Garancitë të pothuajse gjashtë muajve më parë,⁷ Mbrojtja kërkon garanci të mëtejshme që privilegji ligjor në proces nuk është cenuar përmes përgjimit të (i) komunikimeve gojore të Mbrojtjes, përfshirë takimet fizike, konferencat në Zoom dhe thirrjet telefonike, ku marrin pjesë mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi; ose (ii) komunikimeve me shkrim ose shkëmbimeve shkresore të Mbrojtjes, përfshirë komunikimet dhe dokumentet e përcjella përmes sistemit elektronik të të dhënave të Dhomave të Specializuara.⁸ Në mbështetje të argumentit të saj, Mbrojtja parashtroi se, me gjithë përpjekjet përmes korrespondencës *inter partes* me Zyrën Administrative, nuk ka mundur të marrë konfirmimin se në objektin e paraburgimit të DHS-së nuk po kryhen aktualisht incizime audiovizuale të vizitave ligjore.⁹ Si rrjedhojë, Mbrojtja pohon se vazhdon të mos jetë aspak në dijeni nëse përgjohen aktualisht takimet ligjore të privileguara.¹⁰

⁵ KSC-BC-2018-01, F00711, Mbrojtja e z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Garantimin e Mbrojtjes së Privilegjit Ligjor*, 17 qershor 2024, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2018-01, F00717, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigjja e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes për Garantimin e Mbrojtjes së Privilegjit Ligjor*, 28 qershor 2024, konfidenciale.

⁷ Kërkesa, para. 8, 18-19, 21.

⁸ Kërkesa, para. 2, 17, 22-23.

⁹ Kërkesa, para. 9-11.

¹⁰ Kërkesa, para. 8.

5. Duke rikujtuar rëndësinë e komunikimeve të privileguara, sipas rregullave 31(3) dhe 111(1) të Rregullores,¹¹ Mbrojtja parashtron se rreziku i përhershëm i përgjimit nga ZPS-ja të komunikimeve të privileguara me ligj në proces gjyqësor përbën kërcënim të qenësishëm ndaj të drejtave të të akuzuarve dhe përgatitjes e mbrojtjes së tyre.¹²

6. ZPS-ja përgjigjet se nuk nevojitet apo justifikohet asnjë garanci, duke pasur parasysh se: (i) korniza ligjore e DHS-së ofron mbrojtje të fortë të komunikimeve të privileguara midis një personi dhe mbrojtësit të specializuar të tij/saj;¹³ (ii) Mbrojtja nuk ka të drejtë të marrë informacion në lidhje me hetime konfidenciale dhe *ex parte* përveç informacionit që duhet t'i jepet apo njoftohet sipas Rregullores;¹⁴ dhe (iii) Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Veselit dhe Mbrojtja e Selimit kanë marrë tashmë garanci të përsëritura përtej garancive të detyrueshme, si dhe qasje në parashtrime të protokolluara relevante për masat hetimore të posaçme monitoruese, duke u mundësuar të konfirmojnë se deri ku kanë shkuar masat që kanë të bëjnë ekskluzivisht me komunikimet jo të privileguara.¹⁵ Megjithatë, ZPS-ja konfirmon se nuk ka përgjuar asnjë komunikim që mbrohet sipas rregullave 31(3) dhe 111(1) të Rregullores.¹⁶

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Në bazë të nenit 21(4)(c) të Ligjit, i akuzuari gëzon të drejtën të ketë kohën dhe kushtet e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij ose të saj dhe të komunikojë me mbrojtësin e specializuar të zgjedhur prej tij.

¹¹ Kërkesa, para. 13-14.

¹² Kërkesa, para. 8, 17, 19-20, 21. Në këtë kontekst, Mbrojtja vë në dukje se disa vizita ligjore janë kryer në dhomat e takimeve të pajisura me kamera të dukshme. *Shih* Kërkesën, para. 19.

¹³ Përgjigjja, para. 1.

¹⁴ Përgjigjja, para. 1.

¹⁵ Përgjigjja, para. 2.

¹⁶ Përgjigjja, para. 3.

8. Në bazë të nenit 34(1) të Ligjit, Zyra Administrative është përgjegjëse për administrimin dhe shërbimin e Dhomave të Specializuara, si dhe për të gjitha funksionet e nevojshme përkatëse.

9. Në bazë të nenit 34(12) të Ligjit dhe rregullës 23(7) të Rregullores, dhe pa cenuar mbikëqyrjen gjyqësore kur është e nevojshme, Administratori është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e funksioneve dhe objektit të paraburgimit në emër të DHS-së, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Ligjin.

10. Në bazë të nenit 35(2) të Ligjit, ZPS-ja ka autoritetin të zhvillojë hetime penale në kuadër të juridiksionit lëndor të DHS-së, në pajtim me modalitetet e përcaktuara në Ligj.

IV. DISKUTIM

11. Para se të trajtojë themelësinë e Kërkesës, Gjykatësja e Vetme sqaron se Kërkesa përbëhet prej dy komponentësh: (i) konfirmimi se në asnjë moment nuk është urdhëruar incizimi i asnjë takimi të privilegjuar me të akuzuarit në Çështjen 06 në objektin e paraburgimit të DHS-së gjatë masave hetimore të posaçme monitoruese ("Kërkesa për Konfirmim"); dhe (ii) garancia se aktualisht nuk ka asnjë masë hetimore të posaçme monitoruese që mund të zbatohet edhe për takimet e privileguara mbrojtës-klient ("Kërkesa për Garanci"). Këto komponentë do të trajtohen me radhë.

12. Gjykatësja e Vetme rikujton që në fillim se të akuzuarit në Çështjen 06 janë njoftuar dhe kanë marrë qasje në versionet e redaktuara konfidenciale të të gjitha vendimeve dhe parashtrimeve të protokolluara që lidhen me masat hetimore të posaçme monitoruese.¹⁷ Gjykatësja e Vetme rikujton gjithashtu se të akuzuarve në Çështjen 06 u janë dhënë më herët garanci se: (i) masat hetimore të posaçme

¹⁷ Shih KSC-2018-01-RAC001/F00016, Gjykatësja e Vetme, *Njoftim i Mbrojtjes për Lëshimin e Versioneve të Redaktuara Konfidenciale të të gjitha Vendimeve Relevante*, 24 janar 2024, konfidencial dhe *ex parte*, para. 3, 4(a).

monitoruese nuk kanë përfshirë specifikisht monitorimin e komunikimeve të privileguara; (ii) asnjë vizitë e privileguar nuk është incizuar qëllimisht apo jo qëllimisht gjatë periudhës relevante; dhe (iii) në objektin e paraburgimit të DHS-së nuk ka aktualisht asnjë masë hetimore të posaçme monitoruese që do të përfshinte potencialisht takimet e privileguara mbrojtës-klient midis të akuzuarve në Çështjen 06 dhe mbrojtësve të tyre përkatës.¹⁸ Së fundi, Mbrojtja e Krasniqit ka marrë njësoj qasje në të gjitha parashtrimet e protokolluara dhe vendimet në fjalë.¹⁹

13. Sa i përket Kërkesës për Konfirmim, Gjykatësja e Vetme rithekson se nga parashtrimet e protokolluara dhe vendimet që i janë dhënë Mbrojtjes është dukshëm e qartë dhe e pakundërshtueshme se kuadri i masave hetimore të posaçme monitoruese të autorizuar përfshinte vetëm vizitat *e paprivileguara* të të akuzuarve në Çështjen 06 në objektin e paraburgimit të DHS-së.²⁰ Kjo u bë edhe më e qartë në Vendimin mbi Garancitë. Megjithatë, duke pasur parasysh kohën që ka kaluar që prej Vendimit mbi Garancitë, Gjykatësja e Vetme rikonfirmon këto garanci të mëhershme dhe konfirmon se nuk ka pasur asnjë monitorim të komunikimeve të privileguara, në cilindo lloj apo formë të kenë ndodhur ato (vizita fizike, telekomunikime, komunikime me shkrim dhe shkëmbime provash shkresore), midis të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre përkatës në objektin e paraburgimit të DHS-së.

14. Sa i përket Kërkesës për Garanci, duke pasur parasysh shqetësimet e Mbrojtjes, Gjykatësja e Vetme e gjen me vend të garantojë Mbrojtjen se nuk ekziston asnjë urdhër apo vendim tjetër në lidhje me monitorimin e komunikimeve të çdo forme, të të akuzuarve në objektin e paraburgimit të DHS-së, për të cilin ata nuk janë njoftuar.

¹⁸ Vendimi mbi Garancitë, para. 15-17.

¹⁹ *Shih* KSC-BC-2018-01, RAC002/F00006, Gjykatësja e Vetme, *Urdhër për Dhënien e Qasjes në Parashtrime të Protokolluara në Çështjen KSC-BC-2018-01*, 4 korrik 2024, konfidencial.

²⁰ Vendimi mbi Garancitë, para. 15. *Shih gjithashtu, ndër të tjera*, Kërkesën për Monitorimin e Thaçit, para. 1, 37, 39, 42, 43, 50(a); Kërkesën për Monitorimin e Selimit, para. 1, 17, 22-25, 28-29, 32; Kërkesën për Monitorimin e Veselit, para. 1, 7, 28-31, 34-35, 47; Vendimin për Monitorimin e Thaçit, para. 1, 26, 28-33, 38-39, 50(b)(ii); Vendimin për Monitorimin e Veselit, para. 5, 8, 38, 40-42, 44-46, 50-52, 56, 62(c)(ii); Vendimin për Monitorimin e Selimit, para. 5, 8, 27, 29-31, 33-34, 36, 40-41, 52(b)(ii).

V. VENDIM

15. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Vetme:

MIRATON Kërkesën dhe i referohet konfirmimit dhe garancisë së
përcaktuar në paragrafët 13 dhe 14 të këtij vendimi.

/nënshkrimi

Gjykatëse Marzhor Masëlo

Gjykatëse e Vetme

E martë, 16 korrik 2024

Në Hagë, Holandë